

RAPORTI I ZAP 2008

DHE PËRGGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE



SHTATOR 2009
PRISHTINË

PERSONELI:

Ismet KRYEZIU - Drejtor ekzekutiv
email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratës
dhe financave
email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - Asistente për administratë
dhe financa
email: lcikaj@kdi-kosova.org

Emine BEHLULI - Asistente për administratë
dhe financa
email: ebehluli@kdi-kosova.org

PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - Menaxhere e programit
email: mmustafa@kdi-kosova.org

Admir ISTREFI - Asistent Programi
email: aistrefi@kdi-kosova.org

Besnik RAMADANAJ - Zyrtar për marrëdhënie
me publikun
email: bramadanaj@kdi-kosova.org

Sahit BIBAJ - Avokat / Këshilltar juridik
email: sbibaj@kdi-kosova.org

Natyra KASUMAJ - Vullnetare
email: nkasumaj@kdi-kosova.org

Visar RAMAJ - Vullnetar
email: vramaj@kdi-kosova.org

Liridon SELMANI - Monitorues
email: lselmani@kdi-kosova.org

PROGRAMI - QEVERISJA QENDRORE:

Valmir ISMAILI - Menaxher programi
email: vismaili@kdi-kosova.org

Driton SELMANAJ - Asistent i programit
email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Fitore ZENELI - Asistente e programit
email: fzeneli@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - Monitorues
email: izejna@kdi-kosova.org

Ramadan KLISURICA - Monitorues
email: rklisurica@kdi-kosova.org

Rrezarta AHMETI - Monitorues
email: rrahmeti@kdi-kosova.org

PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE

Naim CAHANAJ - Menaxher programi
email: ncahanaj@kdi-kosova.org

Nora VESELI - Koordinator
email: nveseli@kdi-kosova.org

BASHKËPUNËTOR TË JASHTËM

Arsim GJINOVCI - IT & design
email: agjinovci@kdi-kosova.org

Yll BULESHKAJ - Analist
email: ybuleshkaj@kdi-kosova.org

Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP) është Institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në Kosovë. ZAP duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik bën auditimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, organizatave buxhetore, si Kuvendit të Republikës së Kosovës, Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, ministrive si dhe agjencive ekzekutive, komunave, organeve të pavarura, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe subjekteve tjera të cilat janë më shumë se 50% në pronësi publike ose marrin mjete financiare nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës, duke përfshirë edhe Shërbimin Doganor të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Radio Televizionin e Kosovës, Policinë e Kosovës dhe Ombduspersonin. Pas hartimit të Raporteve Financiare Vjetore të Auditimit, ZAP i siguron një raport Kuvendit të Kosovës si dhe çdo institucioni apo subjekti të audituar deri me datën 31 gusht të vitit pas periudhës së kontrollit.¹

Për vitin 2008, ZAP kishte publikuar Raportet e Auditorit për të gjitha institucionet e lartpërmendura. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka bërë analizimin e Raporteve të Auditimit për Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Presidentit, Zyrën e Kryeministrit si dhe për ministrinë, për vitin 2008. Fokus i veçantë u është vënë implementimit të rekomandimeve të viteve të kaluara, politikave alokuese të Qeverisë së Kosovës, mënyrës së shfrytëzimit të buxhetit, shkeljeve të gjetura si dhe rekomandimeve për vitin 2008. Edhe pse të gjitha shkeljet nuk ka pas mundësi të përfshihen në këtë analizë, nga raportet janë nxjerrë vetëm ato që më së shumti tërheqin vëmendjen dhe ato që janë më të rënda, por ngelin pa u përmendur edhe shumë shkelje tjera të cilat ZAP i ka gjetur. Si kriter në përzgjedhjen e shkeljeve ka qenë shuma sa më e madhe e mjeteve të keqpërdorura si dhe kategoria ku shkelja ishte kryer.

¹ Nga faqja zyrtare e internetit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm: <http://www.ks-gov.net/oag/shqip.htm>

I. Sa janë implementuar rekomandimet e viteve të kaluara?

Auditimi nga Zyra e Auditorit Gjeneral mbi pasqyrat financiare për vitin 2007 kishte dhënë rekomandime për secilën nga Institucionet, Ministrinë apo Agjensionet. Gjendja e implementimit të këtyre rekomandimeve është brengosëse, pasi që ato janë implementuar diku rreth 30% deri 40%. Edhe pse rekomandimet e dhëna do të duhej t'i inkurajojnë zyrtarët që sa më shpejt të gjejnë mënyra për të bërë zbatimin e tyre, ato janë implementuar vetëm pjesërisht dhe japin një sinjal për gjendjen menaxhuese jo të kënaqshme në institucione. Mungesa e masave të ndërmarra është një indikator i cili tregon që problemet e viteve të kaluara, janë ende të pranishme nëpër Institucione.

II. Rezultati Financiar në raport me Buxhetin e Aprovuar


Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2008, në bazë të Rregullores 2008/13 kishte vlerën 1,090,332,348 €, e që me Rishikim të Buxhetit 2008, apo Ligjit Nr. 03/L-088 të kapë një vlerë prej 1,122,020,317 €. Nga këto, për Ministrinë/Institucionet ishte ndarë një shumë prej 763,282,080 €, për Organizatat 165,242,479 € dhe pjesa tjetër prej 193,495,758 € ishte ndarë për Komunat. Politikat alokuese të Qeverisë, bazohen në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2009-20011, sipas të cilës Qeveria i ka përcaktuar edhe prioritetet e saj. Në bazë të këtyre prioriteteve, si dhe pas dëgjimeve buxhetore realizohen edhe ndarjet buxhetore të mjeteve për ministrinë apo institucionet tjera.

a. Politikat alokuese të Qeverisë

Në kategorinë e Ministrive/Institucioneve janë të përfshira: Kuvendi i Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, gjashtëmbëdhjetë (16) Ministri², Agjencia Kosovare e Privatizimit, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Akademi e Shkencave dhe Arteve, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, Agjensioni i Antikorrupsionit, Agjensioni Prokurimit Publik, Fondi i Rindërtimit, Zyra Rregullative e Energjisë si dhe Avansi i Ministrisë. Nga ky buxhet prej 763,282,080€ pjesa më e madhe i është alokuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave 195,946,619 € apo rreth 25%, pastaj Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale rreth 20% e në vend të tretë Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomit 18%. Shumica e mjeteve të ndara kanë qenë të dedikuara për kategorinë Investime Kapitale, që do të thotë se Qeveria ka arritur të bëjë ndarjen reale të Buxhetit, duke u bazuar në prioritetet e saj si rritja ekonomike,

² Në analizën tonë nuk janë të përfshira të gjitha ministrinë, pasi që Ministria për Energjetikë dhe Miniera dhe Ministria për Administratën e Qeverisjes Lokale nuk kanë qenë të audituara, ndërsa Ministria për Punë të Jashtme është themeluar pas fillimit të vitit fiskal 2008. Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës nuk ka qenë e përfshirë në ndarjen fillestare buxhetore për vitin 2008.

zbutja e varfërisë dhe rritja e stabilitetit social, ndërtimin e infrastrukturës, kryesisht asaj rurale si dhe arsimin, ndërtimin e shkollave të reja. Analiza kualitative brenda çdo prioriteti ndoshta kërkon një studim më të gjerë, në mënyrë që të fitohet një pasqyrë më e qartë për përzgjedhjet brenda prioriteteve.



1.1. Grafiku i shpërndarjes së Buxhetit për Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Kryeministrit, Zyrën e Presidentit si dhe ministritë.

INSTITUCIONI	BUXHETI 2008	RISHIKIMI	SHPENZIMET
KK	8,719,962	8,836,532	7,671,118
ZPRK	2,588,898	2,638,898	1,194,786
ZK	6,093,771	6,803,405	4,103,138
MEF	171,276,771	195,946,619	83,258,706
MSHP	24,349,921	19,086,767	17,434,350
MBPZHR	8,684,931	10,782,951	9,782,038
MTI	5,745,138	5,745,138	3,969,000
MTPT	111,394,085	139,394,085	126,852,449
MSH	57,891,404	68,503,141	62,629,704
MKRS	9,443,508	11,743,508	10,829,904
MASHT	56,219,869	56,819,869	52,409,806
MPMS	157,657,459	156,730,459	146,370,598
MMPH	12,289,461	12,405,889	4,719,027
MKK	9,118,553	9,468,553	6,327,967
MPB	11,735,919	15,219,485	11,101,294
MD	17,403,857	24,103,418	15,799,077

KK- Kuvendi i Kosovës
 ZKRR- Zyra e Kryetarit të Republikës së Kosovës
 ZK- Zyra e Kryeministrit
 MEF- Ministria e Ekonomisë dhe Financave
 MSHP- Ministria e Shërbimeve Publike
 MBPZHR- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
 MTI- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
 MTPT- Ministria e Transportit dhe Postë - Telekomit
 MSH- Ministria e Shëndetësisë
 MKRS- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
 MASHT- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
 MPMS- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
 MMPH- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 MKK- Ministria për Komunitete dhe Kthim
 MPB- Ministria e Punëve të Brendshme
 MD - Ministria e Drejtësisë

Tabela 1. Krahasimi i mjeteve të alokuara në buxhetin 2008, mjeteve të alokuara me rishikim të Buxhetit dhe mjeteve që Institucionet përkatëse kanë arritur të shpenzohen.


b. Realizimi i Buxhetit:

Nga analiza e Raportit Financiar të Auditorit 2008, në bazë të shpenzimit të buxhetit të alokuar mund të konkludohet për elemente të keq menaxhimit. Në fakt, shumica e ministrive kanë shfaqur një suficit dhe nuk kanë arritur t'i shpenzojnë mjetet e planifikuara brenda vitit fiskal. Gjithashtu, shumë shqetësuese është shuma e lartë e shpenzimeve në muajin dhjetor vetëm sa për të zbutur këtë suficit, si shembull 23,4% prej totalit të shpenzimeve për Mallra dhe Shërbime dhe 38,7% të shpenzimeve për Investime Kapitale ishin bërë në këtë muaj. Nëse bëhet një krahasim në mes të institucioneve, vërehet që performancën më të mirë në shpenzimin e buxhetit e ka shfaqur Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila ka arritur të shpenzojë 93,39% të buxhetit që ka pasur gjatë Rishikimit të Buxhetit 2008. Pas saj, me një performancë të mirë paraqitet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me 92,2% shpenzim të buxhetit, po ashtu edhe Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikimit si dhe Ministria e Shëndetësisë kanë realizuar shpenzim të buxhetit mbi 90%. Në grupin e Institucioneve që kanë arritur të shpenzojnë prej 80% deri 90% të buxhetit të alokuar janë Kuvendi i Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pastaj Ministria e Shërbimeve Publike, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Drejtësisë.

Prijës në grupin e Institucioneve që kanë treguar keq menaxhim gjatë shfrytëzimit të buxhetit është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me vetëm 38% të shpenzimit të buxhetit vjetor, pason Ministria e Ekonomisë dhe Financave me 42,94%, Zyra e Presidentit 45% si dhe Zyra e Kryeministrit, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë si dhe Ministria e Punëve të Brendshme me 60% deri 80% të realizimit të shpenzimeve. Shkalla e dobët e shfrytëzimit të buxhetit nga këto institucione mund të jetë si pasojë e planifikimit të dobët të buxhetit në këto organizata buxhetore - mjetet ndahen në ministri pa pas nevojë prioritare për to ose në mungesë të projekteve konkrete, apo si pasojë e efikasitetit të vogël në realizimin e projekteve të parapara. Sidoqoftë, pa marrë parasysh shkaqet e paraqitjes së suficitit, bllokimi i mjeteve në suficit pamundëson shfrytëzimin e tyre në projekte të ndryshme nëpër ministri tjera që kanë kapacitete për realizimin e projekteve si dhe ato që kanë shfaqur performancë të mirë. Në qoftë se analizohet ky suficit dhe shkalla e shpenzimeve në bazë të kategorive: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale, subvencione dhe transfere si dhe investime kapitale vërehet që kategoria paga dhe mëditje si dhe ajo e subvencioneve dhe transfereve janë realizuar në një përqindje shumë të madhe d.m.th. aty nuk kanë tepruar mjetet financiare dhe janë shfrytëzuar maksimalisht. Suficiti më i madh shfaqet në kategorinë e investimeve kapitale, ku Ministrinë/Institucionet nuk kanë arritur t'i realizojnë projektet e planifikuara brenda vitit fiskal.

Sa për ilustrim, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave me rishikim të buxhetit të alokuara ishin rreth 142 milionë euro. Suficiti i gjithsej për të gjitha kategoritë në këtë ministri përmban shumën prej rreth 112 milionë euro, nga të cilat për kategorinë Investime Kapitale suficit janë rreth 93 milionë euro apo mbi 65% të mjeteve nga buxheti total.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave



Suficiti nëpër ministritë tjera sillet rreth 20-30%, që vërteton menaxhimin e dobët në gati gjitha institucionet. Nga ana tjetër, Zyra e Kryeministrit nga mjetet e buxhetuara për investime kapitale kishte shpenzuar vetëm 14% ose 33,150€, ndërsa Zyra e Presidentit nuk ka arritur të shpenzojë as edhe një euro të vetme në kategorinë investime kapitale dhe të gjitha mjetet prej 1,100,000€ sa u ishin ndarë janë kthyer prapa në përfundim të vitit fiskal. Një fenomen tjetër që vërehet në shpenzim të buxhetit është ai që disa nga institucionet në fund të vitit nuk kanë arritur të shpenzojnë as deri në limitin e ndarjes fillestare buxhetore, kurse të njëjtave me Rishikim të Buxhetit 2008 u janë ndarë edhe mjete shtesë gjë që e përkeqëson dhe e ngritë sasinë e suficitit.

III. Shkeljet e gjetura nga ZAP

Pas analizimit të Raporteve të Auditorit është bërë një përmbledhje e shkeljeve që janë hasur, por ka edhe shumë shkelje tjera që nuk janë të cekura. Fokusimi është bërë vetëm në ato shkelje që kanë qenë më të rënda, edhe pse ka edhe shkelje të vogla të cilat kemi vlerësuar se duhet të cekën varësisht nga kategoria ku ishin gjetur. Karakteri i shkeljeve ka qenë i ndryshëm, duke filluar nga shkeljet në procedurat prokuruese si përzgjedhja e operatorit ekonomik në mungesë të tre (3) operatorëve të përgjegjshëm; përzgjedhja e operatorëve më të shtrenjtë edhe pse në hapjen e tenderit kishte edhe operatorë më të lirë; prokurimi jashtë planit të paraparë (furnizimi me mjete të panevojshme); pranimi teknik nuk bëhet fare ose bëhet nga persona të pa-autorizuar, pastaj shkeljet në rekrutimin e punëtorëve si dhe mos respektimin e konkurseve selektuese. Shkelje të mëdha ishin vërejtur edhe gjatë furnizimit me mallra ku është bërë prokurimi jashtë planit të paraparë (furnizimi me mjete të panevojshme), pranimi nga persona të pa autorizuar, apo mallrat nuk ndodheshin në regjistrat e ministrive. Tejkalimi i shpenzimeve të reprezentacionit, shpenzimeve të telefonit apo derivateve energjetike. Gjatë shpenzimeve për investime kapitale në shumicën e ministrive është gjetur se punimet në projekte të ndryshme nuk kryhen sipas planit dinamik si dhe ato nuk janë në pajtim me specifikacionin teknik, lidhen kontrata me operator ekonomik para se të bëhet zotimi i mjeteve si dhe ipen avanse mbi 30% para se të fillojnë punimet. Rekomandimet që janë dhënë në lidhje me Kontrollin e Brendshëm sugjerojnë shtimin e masave të kontrollit, i cili duket se nuk e luan rolin e tij të vërtetë nëpër Institucionet e Kosovës.

Kategorizimi i shkeljeve sipas Institucionit ku janë gjetur

Kuvendi i Kosovës:

- **Furnizim me materiale, pa aprovim të kërkesës për furnizim:** në shpenzimet e Kuvendit, ZAP ka gjetur se furnizimi me laptop me nr.të kontratës 08-036-121 në vlerë prej 55,556 €, ku nga 82 laptop-top të blerë, për 10 nga ta nuk ka pasur kërkesë të aprovuar.
- **Shkelje e procedurave të prokurimit:** nga të cilat, në Kuvendin e Kosovës janë gjetur edhe: mos njoftim të kompanive ofertuese për eliminimin e tyre, mosekzekutim të punëve dhe shërbimeve të kryera sipas planit të liferimit, moskryerje të pagesave ndaj kontraktorëve, etj.
- **Tejkalimi i shpenzimeve të reprezentacionit:** gjatë vitit 2008 këto shpenzime të reprezentacionit janë tejkaluar me vlerën 5,719 €.

Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës:

- **Nënshkrimi i kontratave të paqarta:** kontrata e nënshkruar me datën 26.02.2008 është e paqartë dhe e tipit kornizë, sipas çmimit për njësi. Në pikën 17.0 vlera e kontratës për njësi është 7,465.64€, ndërsa në pikën 17.1 çmimi për njësi (për një automjet) është 2,854.50 euro. Nuk është përdorur forma standarde e Kontratave. Shuma e pagesave të kryera ka qenë 18,370 euro.
- **Keqpërdorime në mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve zyrtare:** për automjetin “TOYOTA” është bërë furnizimi me artikuj që nuk kanë qenë në specifikacion teknik dhe që nuk janë në ofertën e kontraktit, në këtë mënyrë janë bërë furnizime dhe pagesa të pa autorizuara, shuma e të cilave është 3,650€.
- **Tejkalimi i shpenzimeve të telefonit:** prej 38 shfrytëzuesve të telefonisë fikse, 9 prej përdoruesve kanë tejkalluar shpenzimet e lejuara. Shuma e përgjithshme e tejkalimeve gjatë vitit është 1,706€. Për më tepër në listën e telefonave fikse, 13 numra të telefonit janë të papërdorshëm, por për të cilët bëhet pagesa për taksë çdo muaj. Edhe te shfrytëzimi i telefonisë mobile (roaming) ka tejkalime po ashtu të ndjeshme. Vlera e tejkalimeve nëpër muaj arrin në 1,848 €. Madje ka rast kur për muaj ka arritur vlera e shpenzimit deri në 389.77€ (korrik) prej një personi, kurse të lejuara ka 100€ në muaj, një zyrtar tjetër ka arrit vlerën e shpenzimeve për muajin nëntor 446.35€ të lejuara e ka vlerën prej 100 € në muaj.

Zyra e Kryeministrit:

- **Shkelje në procedurat e shpenzimeve të reprezentacionit:** Zyra e Kryeministrit kishte paguar gjatë vitit 2008 shumën prej 172,743 € në emër të shpenzimeve të reprezentacionit. Në gjashtë (6) mostra të audituara nuk specifikohen llojet e shërbimeve (ushqim, piçe) si dhe kontratat nënshkruhen nga Shefi i kabinetit të Kryeministrit dhe pa zotim të mjeteve (ky zyrtar nuk është i autorizuar për nënshkrimin e dokumenteve kontraktuese) ;
- **Mungesa e regjistrave gjithëpërfshirës të pasurive:** në vitin 2007 pasuritë jo financiare janë raportuar në shumën prej 201,996 €, kurse Raporti Vjetor Financiar i BKK-së për 2008 ka raportuar pasuritë në shumë prej 125,719 € d.m.th. janë raportuar 76,277 € më pak.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave:

- **Pagesa e avanseve mbi 30% pa aprovim nga ana e Ministrit:** ndërtimi i objektit të ATK-së në Prizren -Kontrata është nënshkruar më 22.12.2008, ndërsa dy ditë më vonë është bërë pagesa në avans në vlerë 353,995€ respektivisht 30%, diferenca e mbi paguar është në vlerë prej 117,998€. Kjo pagesë është bërë pa aprovim nga ana e Ministrit.

- **Shkelje në procedurat e prokurimit për mirëmbajtjen e veturave:** servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare Nisan Terrano 2.7 TDI. Në procedurat e prokurimit për “servisimin dhe mirëmbajtjen e veturave zyrtare Nisan Terrano 2.7 TDI” specifikacioni teknik ka kërkesa (artikuj) të cilat nuk janë pjesë e këtij tipi të veturës. Operatorët i kanë dhënë çmimet reale për artikujt e atyre kërkesave, ndërsa operatori i cili është shpërblyer me kontratë, këta artikuj të këtyre kërkesave i ka ofruar me çmime prej 0.01€. Kjo krijon dyshimin se përpiluesi i specifikacionit teknik të këtij prokurimi e ka bërë me qellim që t’i mashtrojë operatorët ekonomik serioz të cilët i kanë dhënë çmimet reale për ato pjesë. Fjala është për 13 nga 272 artikuj, respektivisht pjesë të veturës.

Ministria e Shërbimeve Publike:

- **Përzgjedhja e ofertuesit më të shtrenjtë:** në kontratën me numër: 124-08-152-121 në ESK Furnizimi me Pajisje të IT me vlerë prej 59,320 € nuk janë respektuar kriteret e përzgjedhjes së ofertuesit. Është zgjedhë operatori ekonomik me çmim ma të lartë, ku ka pas ofertues të tjerë me çmim më të ul prej 28,257€, që i ka plotësuar kriteret dhe nën kriteret për shpërbllim të kontratës.

- *Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil,*

- **Mosharmonizimi i të dhënave të Sistemit të Pagave me Librin Kryesor të Thesarit,** Sistemi i Pagave, i cili administrohet nga MSHP ka bërë harmonizime me Librin Kryesor të Thesarit. Mirëpo diferenca e paraqitur në tabelën më poshtë paraqet shpenzime të proceduara nga Thesari të pagave neto të cilat nuk kanë kaluar nëpërmjet sistemit të pagave dhe ndryshimeve të kodeve gjate regjistrimit nga ana e Thesarit. Nga kjo tabelë mund të shihet se ka pasur diferenca për disa Organizata Buxhetore. Në total kjo diferencë është 442,394 euro ose për 0.24%.

Kodi 11110 sipas Thesarit	Pagat neto sipas Pejrollit	Diferenca	Diferencat në %
184,164,276 €	183,721,882 €	442,394 €	0.24%

Tabela2: Raporti në mes të dhënave të marra nga Libri Kryesor i Thesarit për kodin 11110 (kodi I pagave neto) dhe Pagave neto sipas të dhënave të Sistemit të Pagave.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

- **Përzgjedhja e ofertuesit më të shtrenjtë:** në kontratat e ofruara për shërbime të ndryshme, kjo ministri ka angazhuar kompani, madje me çmime më të larta deri në 56.058 euro.
- **Shkelje në procedurat e prokurimit:** edhe në këtë ministri, janë vërejtur pagesa të kryera, pa përfunduar punët, edhe pse aneksi kontrata specifikon që pagesa të bëhet pas përfundimit të shërbimeve të kontraktuara. MBPZHR po ashtu është furnizuar me artikuj që nuk ishin paraparë më kontratën e nënshkruar.
- **Shkelje në dhënien e subvencioneve:** kjo ministri i ka dhënë donacion fermerit i cili nuk i ka plotësuar as 50 % të kriterëve të kërkuara nga ministria.
- **Emërime pa konkurs publik:** në MBPZHR, në disa raste janë bërë emërime të zyrtarëve pa konkurs publik, nuk ka zyrtar të të hyrave, etj. ZAP ka gjetur edhe katër (4) raste të konfliktit të interesit brenda ministrisë.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë:

- **Përzgjedhja e ofertuesit më të shtrenjtë:** kriter bazë për shpalljen e fituesit ka qenë “Oferta ekonomikisht më e favorshme” Operatori Ekonomik “Hidroterm” ka fituar kontratën duke u poentuar më së larti, mirëpo ky OE ka dështuar të përfundojë punimet në përputhje me ofertën e paraqitur. Gjatë fazës së ofertimit, tre (3) ofertues tjerë kanë pasur çmime më të lira, ku dallimi në mes të fituesit dhe ofertuesit më të lirë OE “Alfa.i.&Kag asfalt” është €244,675.

Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit:

- **Shkelje të procedurave të prokurimit:** Sa i përket njësive të patentë shoferëve, ZAP vlerëson se nuk ekzistojnë kontrolle adekuate mbi procesin e organizimit të provimeve për patentë shoferë. Ndërsa sa i përket shpenzimeve përmes procedurave të prokurimit, është gjetur se janë dhënë kontrata edhe pse nuk i kanë përmbushur kushtet minimale ekonomike dhe financiare sipas tenderëve. Ka raste kur janë shpallur fituese, kompanitë me çmime më të larta të ofruara.
- **Arkëtimi i dobët i të hyrave nga bizneset e kyçura ilegalisht në rrugë:** mos ndërmarrja e masave nga ana e MTPT-së për bizneset që janë kyçur ilegalisht në rrugë dhe arkëtimi i dobët i të hyrave nga bizneset që kanë marrë pëlqimin për kyçjen në rrugë, ka bërë që borxhet e papaguara prej vitit 2001 deri në vitin 2008 arrijnë shumë prej 2.144.124 euro.

Ministria e Shëndetësisë

- **Mungesa e regjistrave financiar:** Ministria e Shëndetësisë nuk posedon regjistra të plotë financiar burimor të cilët do të shfrytëzoheshin për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe do të mbështetnin të dhënat e paraqitura nga Pasqyrat Financiare.
- **Shkelje në lidhjen e kontratave:** në lëndën “furnizimi me pjesë rezervë dhe pajisje medicinale” në vlerë 95.019 euro, auditori ka gjetur se kontrata ishte lidhur me 19 dhjetor 2008, dhe të njëjtën ditë është bërë edhe pagesa e plotë, edhe pse në kontratë parashihet që pagesa e fundit të bëhet pas pranimit përfundimtar të mallrave.
- **Pranimi i mallrave nga persona të pa autorizuar,** pranimi i mallrave (Barnave të Listës Esenciale) ishte bërë nga personi i pa autorizuar, ndërsa nuk mbahen raporte komplete për Barnat e Listës Esenciale. MSH nuk ka mundur t’i ofroj ZAP-it të dhëna të plota rreth kërkesave

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- **Përzgjedhja e operatorit më të shtrenjtë dhe ekonomikisht të papërgjegjshëm,** në ndërtimin e palestrës sportive në Drenas, ishte përzgjedhur operatori ekonomikisht i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët. Komisioni vlerësues kishte përzgjedhur si fitues të tenderit operatorin N.N “Polluzha” nga Drenasi, i cili ka qenë për 11.851 euro më i shtrenjtë se operatori ekonomik “Inxhinjering”. Të dy operatorët nga ana e komisionit për vlerësim ishin kualifikuar si ekonomikisht të përgjegjshëm.
- **Të hyrat nuk depozitohen në bankë:** nga të hyrat e kësaj ministrie, janë evidentuar disa parregullsi, si: paratë e arkëtuara me rastin e shitjes së biletave nga ana e Teatrit Kombëtar, si dhe paratë e arkëtuara nga pagesa për anëtarësi në biblioteka dhe shërbime tjera, nuk depozitohen në bankë dhe nuk regjistrohen në sistemin e thesarit.
- **Mjetet paraqiten si të shpenzuara, ndërsa ato gjinden të depozituara në bankë,** në kategorinë e Investimeve Kapitale është paraqitur vlera prej 128.000 si shpenzim i ndodhur gjatë vitit, ndërsa projektet për të cilat ajo shumë ishte dedikuar, nuk kishin filluar ende të realizohen. Paratë në realitet nuk janë shpenzuar, por ato gjinden të depozituara nëpër llogaritë e bankave komerciale të hapura nga ana e institucioneve nën administrimin e MKRS-së.
- **Marrja e pagave edhe pas skadimit të kontratës,** ZAP ka gjetur kontrata jo të vlefshme me afat të skaduar. Për vitin 2008, MKRS kishte paguar përmes subvencioneve mbi 316 paga tjera mujore sipas kontratës mbi vepër. Shuma e paguar për 316 të punësuarit në sistemin payroll ishte 902.446 euro, ndërsa për 316 të punësuarit me kontratë mbi vepër ishte 681.733 euro.

-
- **Lidhja e kontratave para zotimit të fondeve:** janë evidentuar parregullsi në blerjen e pajisjeve të ndryshme. Është nënshkruar kontrata për furnizimin me llap-topa për nevoja të ministrisë, para zotimit të fondeve (ose pa fonde të mjaftueshme).

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë:

- **Shkelje të kontratave:** tek një kontratë në vlerë prej 1,090,789 punë kryesi ka kryer punë të cilat nuk janë përfshirë në kontratë, edhe pse ishte kërkuar nga menaxheri i projektit që këto punë mos të kryhen .
- **Ngecje në dinamikën e ndërtimeve:** në dy kontrata me vlerë 3,457,175 të ndërtimit të shkollave ka pasur ngecje në dinamikën e ndërtimeve. Pas 85 ditëve ,nuk është kryes asnjë punë tjetër përveçse gërryerja e terrenit.
- **Puna e pa ekzekutuar pranohet si punë e kryer:** mbi pagesat- nga 4 mostra në vlerë prej 7,286,585 te testuara auditori ka gjetur se një pjesë e punës të pa ekzekutuar është pranuar si e kryer dhe është miratuar pagesa e saj.
- **Paqartësi në pranimin e pajisjeve:** tek një kontratë për furnizime me pajisje teknologjike Informative në vlerë 153.530 raporti për pranim nuk jep informacione se kush ka marr pjesë në Komisionin për pranimin e pajisjeve nëpër 7 qendrat e Kosovës.
- **Keq menaxhimi me paranë e gatshme:** në Qendrën Studentore dhe Institutin Albanologjik, në këto raste është gjetur se personat përgjegjës nuk ka qenë në gjendje të barazojnë arkën ,ndërsa në Institutin Albanologjik nuk ka kasaforte fare dhe paraja ruhet në shtëpinë e Personit përgjegjës.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale:

- **Keq përdorimi i derivateve gjatë shfrytëzimit të veturave:** për 2 (dy) vetura nga kabineti i Ministrit nuk ishin ofruar dëshmi për regjistrimin e kilometrave të kaluara. Për 7 (shtatë) vetura tjera pjesërisht ishin regjistruar kilometrat e kaluara, andaj bazuar në këto shënime të mangëta të ofruara mesatarja e shpenzimit të karburanteve del të jetë 44,5 litra/100 km. Ndërsa për të gjitha veturat tjera mesatarja e shpenzimeve është 15 litra/100 km.

- **Tejkalimi i shpenzimeve të telefonit:** nga mostrat e përzgjedhura për shpenzimin e telefonit roaming për muajin qershor 2008 është konstatuar se numri 044/509-620 ka tejkaluar shpenzimet e lejuara në shumë prej 61 euro. Ndërsa për shpenzimet e telefonisë fikse për mostër ishin marr shpenzimet e muajit Shtator dhe Dhjetor 2008 dhe me testimet e bëra ishte konstatuar tejkalim të limitit të lejuar, sipas Vendimit Nr 81 të datës 03.03.2008 për zbatimin e UA 04/2008. Tejkalimi i shpenzimeve të lejuara arrin shumës prej 4.255 € (apo 65% më tepër se shpenzimet e lejuara).
- **Avanset zyrtare të pambyllura:** avanset për udhëtime zyrtare nuk janë mbyllur për vitet 2005 deri 2008 me një vlerë prej 33,267€, kurse vlera prej 25,847€ nuk është arsyetuar me dokumentin përkatës.
- **Keq menaxhimi me paranë e imët:** paraja e imët nuk është mbyllur në vitin 2008 në vlerë prej 5,000€ dhe janë dhënë avance në vlerë prej 2,753 €. Nga këto të dhëna është konstatuar se organizata buxhetore ka vepruar në kundërshtim me ligjin Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe UA Nr. 2008/10.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:

- **Anashkalimi i procedurave gjatë lidhjes së kontratës për qira:** gjatë ekzaminimit të lëndës lëshimi i objektit me qira në hapësirat e IHM, MMPH ka lidhur kontratë me qiramarrësin duke anashkaluar procedurat e hapura për oferta publike, kontrata është lidhur me datë 09/01/07 me nr. 06/32/2 nga zyrtari më i lartë administrativ.
- **Mungesa e Komisioneve për pranimin e punëve:** gjatë ekzaminimit të lëndëve është vërejtur se MMPH nuk ka formuar komisione për pranimin e punëve të realizuara nga operatorët ekonomik .- Rehabilitimi i deponisë së mbeturinave në Ferizaj në vlerë prej 148.945 -Ekzekutimi i punëve në kompleksin memorial Adem Jashari në vlerë prej 981,999,91, ndërsa vlera e paguar në tre këste 589.200 euro.
- **Furnizim me aparat telefonik mobil “Iphone”:** Furnizimi dhe pajisja me telefona mobil në vlerë prej 6,930.00 euro .Kabineti i ministrit është furnizuar me telefona mobil (Ifone) në vlerë të lartë prej 750 euro 550 euro.
- **Keqpërdorime në shfrytëzimin e automjeteve zyrtare:** Automjetet zyrtare janë marrë në përdorim pa aprovimet përkatëse, mungesë të evidencave mbi kilometrat e kaluara gjatë shfrytëzimit të automjeteve, shumica e faturave nuk kanë qenë në specifikacione teknike të dosjes së tenderit .

Ministria për Kthim dhe Komunitete:

- **Mobiliet e ministrisë kalojnë në dispozicionin privat të ministrit:** ZAP ka gjetur se mobiliet e blera afër 10.000 euro, nuk gjenden në ministri, por janë në dispozicion të ministrit. Po ashtu janë gjetur disa raste të ndryshimit-përmirësimit të faturave, duke ndërruar shumën.
- **Keqpërdorime në rekrutimin e punëtorëve:** Nga realizimi i buxhetit është gjetur se shumica e personelit nuk e kanë nënshkruar listën e pagave. Dhjetë (10) punonjës nga 14 mostra të audituara me vendim të sekretarit permanent janë pranuar në punë si ushtrues detyre në pozita përkatëse, pastaj është bërë shpallja e konkursit për rekrutim, edhe pse të gjithë nuk i kanë plotësuar kriteret, duke u favorizuar kështu nga komisioni vlerësues.
- **Tejkalim i shpenzimeve për furnizim me kompjuterë:** Tek shpenzimet për blerje të kompjuterëve dhe pjesëve tjera, janë parashikuar të shpenzohen 16.000 euro, ndërsa janë shpenzuar 26.459 euro, apo mbi 10.000 euro më shumë. Janë blerë tre llap-top në vlerë prej 3.300 euro, e që nuk gjenden në evidencën e pasurisë.

Ministria e Punëve të Brendshme:

- **Shkeljet në procedurat e rekrutimit:** në tri (3) raste punësimi, janë lidhur kontrata pune pa procedurë rekrutuese dhe pa vendim përkatës. Po ashtu, për tre punëtorë janë lidhur kontrata të punës më herët, pastaj është bërë shpallja e konkursit, etj.
- **Shkelje në procedurat e prokurimit:** në prokurimin me nr. 214/207/08/073/236 në regjistrin e tenderëve të dorëzuar janë të evidentuar katër (4) kompani ofertuese, kurse në procesverbalin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave janë evidentuar pesë (5) kompani.
- **Mbivlerësim të faturave:** Tek investimet kapitale, në dy kontrata në vlerë të përgjithshme prej 480.725 euro ka pasur mbivlerësim të faturave. Për tri raste të ndryshme, janë identifikuar rritje të faturave në vlerë prej 9.009 euro.

Ministria e Drejtësisë:

- **Mbivlerësimi i kontratave:** Furnizimi me pajisje dhe material shpenzues mjekësor si dhe servisimi i aparateve mjekësore të Lot 2 dhe 5 kontrata nuk nënshkruhet sipas çmimit të komisionit vlerësues, por mbi vlerësohet për Lot-in 2 nga 49,955€ në 54,255€ dhe për Lot-in 5 nga 1,215€ në 1,681€ (diferenca 4,300€ dhe 366€) që d.m.th buxheti dëmtohet për 4,666€.

- **Keqpërdorime në pagesën e qirasë:** Ri-tenderimi për marrjen me qira të hapësirave për zyre të departamenteve të MD, në Prizren: Kontrata është nënshkruar për hapësirën prej 1,300 m² x 6,3 = 8,190€, ndërsa sipas përshkrimit teknik të objektit ka një hapësirë prej 944,3 m² x 6,3 = 5,949€, d.m.th. paguhet më tepër 355.7m² x 6,3= 2,240€/muaj, gjegjësisht 2,240.91 x 12=26,890€ dëmtim i buxhetit në vit.

IV. Gjendja e rekomandimeve për vitin 2008

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në raportet e tij për vitin 2008 nga 16 raporte të auditimit sa janë analizuar, kishte dalë me 181 rekomandime të reja gjithsej. Më së shumti rekomandime të reja ka për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjithsej 19, pastaj për Ministrinë e Shëndetësisë 18 rekomandime, kurse nga 15 rekomandime kanë Ministria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Ministria e Shërbimeve Publike. Më së paku rekomandime ka për Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës vetëm pesë (5), pastaj për Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomit shtatë (7).

V. Rekomandime

- Rekomandohet Komisionet përkatëse të Kuvendit të Kosovës që të kërkojnë një analizë nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave mbi shkaqet e një zbatimi kaq të ulët të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave të bëjë një planifikim më të mirë të buxhetit, në mënyrë që mos të përsëritet suficiti kaq i madh;
- Zyrtarët e prokurimit publik të japin përgjegjësi juridike, në institucionet ku janë gjetur shkelje të procedurave të prokurimit;
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, si përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, të bëjë shtimin e kontrollit ndaj autoriteteve kontraktuese;
- Prokuroria të ushtrojë ndjekjen penale ndaj zyrtarëve institucionalë në ato institucione ku janë gjetur shkeljet;
- Të rriten kapacitetet audituese të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;

VI. Përfundim

Institucionet duhet ta analizojnë me seriozitet Raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të bëjnë implementimin e rekomandimeve që kjo zyrë i ka dhënë. Duke u bazuar në rekomandimet e vitit të kaluar si dhe rekomandimet për vitin 2008, zyrtarët institucional duhet të gjejnë mënyra se si ta përmirësojnë performancën e tyre në institucione. Këto rekomandime duhet të shërbejnë si njëri nga udhëzuesit e përmirësimit të punës institucionale dhe implementimi apo mos implementimi i tyre në të ardhmen, do të mund të shërbejë si një indikator shumë real i funksionimit institucional. Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2008, si dhe politikat alokuese gjatë Rishikimit të Buxhetit 2008, së bashku me Raportin Gjashtëmujor të Shpenzimeve të Buxhetit të vitit 2009 si dhe Prioritetet e Qeverisë të parapara në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2010-2012 duhet t'i shërbejnë Departamentit të Buxhetit në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, gjatë hartimit të Buxhetit për vitin 2010. Prokuroria, duke u bazuar në shkeljet që ZAP i gjen gjatë auditimit të Institucioneve të fillojë procedurat juridike gjegjësisht ndjekjen penale. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm duhet ta ruajë pavarësinë që e ka dhe të mos bjerë pre e presioneve politike, pasi që ajo është njëra ndër pasqyruesit dhe matësit e punës së Institucioneve të Kosovës.

Bibliografi

Dokumentet me të cilat është shërbyer Instituti Demokratik i Kosovës gjatë përgatitjes së kësaj analize :

- Ligjit Nr. 03/L-088 për ndryshimin e rregullores së Unmik-ut 2008/13 mbi miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimeve të autorizuara për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008
- Raporti Vjetor i Auditimit për vitin financiar 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Kuvendit të Kosovës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Shërbimeve Publike për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2008
- Rregullorja e UNMIK-ut 2008/13



Mbështetur nga:

